



Qeveria e Republikës së Maqedonisë

**KOMISIONI KOMBËTAR PËR
LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT
ME QENIET NJERËZORE**

**STRATEGJIA KOMBËTARE PËR
LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT ME QENIET
NJERËZORE DHE EMIGRIMIN ILEGAL
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

**AKSION PLANI KOMBËTAR PËR
LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT ME QENIET
NJERËZORE DHE EMIGRIMIN ILEGAL
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

2013-2016



Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



On behalf of
Federal Ministry
for Economic Cooperation
and Development

Të nderuar,

Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal është dokument i cili parashikon masa dhe aktivitete të institucioneve përgjegjëse të drejtuara kah zbulimi dhe ndjekja e keqbërësve si edhe një qasje (akses) të ndërlikuar për përmirësimin e statusit të viktimave të trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë.

Strategjia kombëtare dhe Aksion plani kombëtar për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal 2013 – 2016, është dokumenti strategjik i tretë me radhë i përpiluar nga Komisioni Kombëtar në bazë të nevojave nga terreni, dhe i pasqyron (reflekton) tendencat aktuale në Republikën e Maqedonisë.

Aktiviteti i Komisionit për përpilimin e dokumenteve buron edhe nga dedikimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në dhënien e përgjigjes efikase ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal.

Këta dy dokumenta me përgjigje kombëtare ndaj obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë dhe përpjekjet për të bashkuar të gjitha qëndrimet, aktivitetet dhe resurset në një kornizë (kuadër) koherente është qasja e vetme për zhvillimin e qëndrueshëm në avansimin e të drejtave të viktimave të trafikimit me qeniet njerëzore.

Qasje e partneritetit e Komisionit Kombëtar me institucionet relevante, Shoqatat e qytetarëve dhe Organizatat ndërkombëtare është shumë e rëndësishme në krijimin e përbajtjeve të APK të vitit 2013 – 1016. Gjatë përpilimit janë marrë në konsiderim rekomandimet e Koordinatorit kombëtar, Raportuesit Kombëtar, rekomandimet prej raportit të Departamentit Shtetëror të SHBA gjatë rangimit rë Republikës së Maqedonisë në TIER 1 shtetet për vitin 2011, Strategjisë së UE për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore për vitin 2013 – 2016, rekomandimet prej vlerësimit të zbatuar të APK 2009 – 2012 dhe dokumentave të tjera relevante.

APK i ri ofron qasje komplekse në zvogëlimin (reduktimin) e ndjeshmërisë së grupeve të rrezikuara dhe viktimave potenciale të trafikimit të qenieve njerëzore që është edhe përbetimi i Komisionit Kombëtar në aktivitetet e tij programore. Në të njëjtën kohë, APK ofron mekanizma adekuate për tejkalimin e problemeve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal, qasje të mirë, respektimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore/fëmijë dhe emigrantë ilegal dhe parashikon mbrojtjen e tyre përkatëse dhe efikase, duke vendosur gjatë kësaj një qasje sistematike në menaxhimin me të dhënat, mbajtjen e statistikës dhe ndërtimin e praktikave të mira.

Me qëllim që të shqyrtohen dhe ndiqen nevojat specifike të fëmijëve/ viktima si një kategori e ndjeshme e veçantë dhe që të realizohet mbrojtja e tyre në kuadër të APK për 2013 – 2016, janë ndarë aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me fëmijët viktima të trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal në shfaqje të veçantë tabelare.

Përpilimi i APK 2013 – 2016 është i mbështetur nga Shoqata gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (GIZ).

Me respekt,

Violeta Jankovska

Koordinator Kombëtar për luftën kundër
trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrim ilegal

PËRMBAJTJA

Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë	7
Aksion plani kombëtar për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë	47
Ekstrakt nga Aksion Plani Kombëtar për luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal që ka të bëjë me Aksion Planin për luftën kundër trafikimit me fëmijët në Republikën e Maqedonisë.....	63

**STRATEGJIA KOMBËTARE PËR
LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT ME
QENIET NJERËZORE DHE
EMIGRIMIN ILEGAL NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË**



SHPJEGUESI I SHPREHJEVE DHE DEFIONICIONEVE TË PUNËS¹

1. Trafikimi me qeniet njerëzore	Sipas nenit 3 (a) nga Protokolli i KB për pengimin, shpartallimin dhe ndëshkimin e trafikimit të qenieve njerëzore, në veçanti me femra dhe fëmijë (Protokolli i Palermos), i cili plotëson Konventën e KB për luftën kundër krimit të organizuar trans-nacional (2000), “trafikim me qeniet njerëzore” paraqet rekrutimin, transportimin, transferimin, ruajtjen ose pranimin e personit, me shfrytëzimin e mjeteve si kërcënimini ose detyrimi me forcë ose përdorimi i forcës ose formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, gjënimit, keqpërdorimit të pozitës së ndjeshmërisë ose dhënes dhe marrjes së pagesës ose përfitimit me qëllim të marrjes të pëlqimit të personit i cili ka kontroll ndaj një personi tjetër, me qëllim të eksploatimit. Eksploatimi përfshin minimum eksploatimin e prostitucionit të personave të tjerë ose forma të tjera të eksploatimit social, punë të dhunshme ose shërbime, skllavëri ose veprime të tjera të ngjashme me skllavërinë, robërim ose largimin e organeve.
	Sipas nenit 3 (b) nga Protokolli i Palermos i KB, rekrutimi, transportimi, transferimi, ruajtja ose pranimi i fëmijëve me qëllim eksploatimi, do të llogaritet si “trafikim me qeniet njerëzore” edhe në rastet kur nuk janë përfshirë mjetet e dhëna në paragrafin (a).
	Sipas nenit 3 (b) nga Protokolli i Palermos i KB, “fëmijë” llogaritet secili person i cili nuk ka mbushur 18 vjet.
2. Puna e dhunshme	Sipas Konventa për punën e dhunshme nr. 29 (1930) të OBSH shprehja “punë e dhunshme” domethënë secili lloj i punës i cili është nxjerrë me detyrim nga ndonjë person nën kërcënim për ndonjë ndëshkim dhe për të njëjtën personi nuk është ofruar në mënyrë vullnetare.
3. Robëria	Sipas nenit 1 nga Konventa e KB për robëri (1926), robëria është status ose gjendje e personit mbi të cilin demonstrohet fuqi si e drejtë e pronësisë.
4. Kontrabandimi	Sipas Protokollit të KB për kontrabandimin e emigrantëve nëpërmjet tokës, detit dhe ajrit, i cili plotëson Konventën e KB për luftën kundër krimit të organizuar trans-nacional (2000), “kontrabandimi i emigrantëve” domethënë fitimi, në mënyrë direkte ose indirekte, finansiar ose leverdi tjetër materiale nëpërmjet të hyrjes ilegale të personit në shtet në të cilin personi nuk është shtetas ose banor i përhershëm.
5. Emigrimi ilegal	Sipas organizatës ndërkombëtare për emigrim (IOM), emigrimi ilegal ka të bëjë me format më të shpeshta të emigrimit të parregullt, në veçanti hyrje ilegale, qëndrim dhe punë e pautorizuar, dhe definohet si lëvizje e cila shërben jashtë normave rregullative në shtetet në të cilat dërgohen, nëpër të cilat kalohet tranzit dhe të cilat pranojnë emigrantë.

¹ **Burimet e shfrytëzuara:** Shpjeguesi i shprehjeve i IOM; QNPPM, “Udhëzues për përpilimin dhe implementimin e luftës gjithëpërfshirëse kundër trafikimit me qeniet njerëzore”, Programi evropian përfshirës qëndrimin e luftës kundër trafikimit me qeniet njerëzore në Evropën Juglindore, 2006, në dispozicion në <http://www.anti-trafficking.net>; Komisioni Kombëtar për luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimit ilegal, Procedurat operative standarde për trajtimin e viktimateve të trafikimit me qeniet njerëzore, 2010.

6. Grupet e rrezikut	Personat e përjashtuar në aspektin social: materialisht të pasiguruar, personat prej komuniteteve etnike të caktuara, persona/ fëmijë të eksploatuar në punë, persona/ fëmijë të cilët kërkojnë lëmoshë, persona/ fëmijë me probleme në familje, fëmijë të përjashtuar nga procesi arsimor, fëmijë të cilët jetojnë pa prind/ kujdestar të përcaktuar, fëmijë prej institucioneve, kryes të veprave penale që janë minor të braktisur nga arsimi, viktima të dhunës në familje.
7. Victimë e krimit	Sipas Deklaratës së KB të vitit 1985 për parimet themelore të drejtësisë për victimat e krimit, "victimë" domethënë një person i cili, në mënyrë individuale ose kolektive, ka përjetuar dëm, përfshirë këtu dëmtimin fizik ose mendor, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose shkelje të rëndësishme të të drejtave themelore të tij, nëpërmjet të veprave të cilat shkelin ligjet penale të cilat vleinë në shtetet anëtare, përfshirë këtu edhe ata ligje të cilat rregullojnë keqpërdorimin penal të fuqisë.
8. Viktima të trafikimit me qeniet njerëzore	Personat të cilët caktohen si viktima të trafikimit me qeniet njerëzore në pajtim me nenin 3 të Protokollit të KB ose legjislacionit kombëtar për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe persona të cilët janë identifikuar në mënyrë ligjore si viktima të trafikimit të qenieve njerëzore nga ana e pushtetive përkatëse.
9. Victimë e mundshme	Personi për të cilët ekzistojnë indikacione se janë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, por të cilët zyrtarisht nuk janë identifikuar nga ana e organeve kompetente (përbushin kriteret e Protokollit të KB për trafikimin e qenieve njerëzore).
10. Mekanizmi kombëtar për udhëzim	Sistem i bashkëpunimit nëpërmjet të cilil institucionet kombëtare i përbushin përgjegjësistë e tyre për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut të viktimateve të trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo është e lidhur me vendosjen e mekanizmave në nivel kombëtar, ashtu që të mundet të sigurojë sistemet efiqas të identifikimit, udhëzimit, pranimit, ndihmës dhe mbrojtjes së viktimateve. Zyra e Mekanizmit kombëtar për udhëzim funksionon në kuadër të Ministrisë për punë dhe çështje sociale nga shtatori i vitit 2005.
11. Mekanizmi trans-nacional për udhëzim	Mekanizma dhe sisteme të cilët janë përpiluar për ndihmë gjithpërfshirëse dhe mbështetje trans-nacionale për victimat. Mekanizmat trans-nacionale për udhëzim lidin tërë procesin për udhëzim nga identifikimi fillestar deri te kthimi dhe ndihmë në shtetet e tranzitimit, shtetet e destinimit dhe shtetet e origjinës, përfshirë këtu bashkëpunimin midis institucioneve qeveritare të ndryshme dhe akterëve joqeveritar.



12. Procedurat operative standarde	<p>POS për mënyrën e veprimit me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore rregullojnë veprimet, procedurat dhe mënyrat e sigurimit të ndihmës dhe mbrojtjes së të gjitha viktimate të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet të një qasje gjithëpërfshirëse të bazuar në të drejtat e njeriut dhe fokusohen te viktimat në formë të kornizës institucionale për bashkëpunim.</p> <p>Masat e POS përfshijnë sferat vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i iktimata të trafikimit të qenieve njerëzore; - Statusin juridik të viktimate të trafikimit të qenieve njerëzore; - Ndihma e viktimate të trafikimit të qenieve njerëzore para se të kthehen si edhe masat për integrim në shtetin e destinimit; - Kthimi i viktimate të trafikimit të qenieve njerëzore; - Ndihma dhe ri-integrimi i viktimate të trafikimit të qenieve njerëzore pas kthimit – në vendin e origjinës; - Procedurat penale në të cilat janë përfshirë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore si dëshmitarë; - Kompensimi i dëmit.
13. Mbrojtja dhe masat	<p>Masat, programet dhe shërbimet të cilat kanë për qëllim rehabilitimin e vitkimeve, sipas nenit 6 të Protokolit të Palermos të KB. Këta masa mund të janë të ofruara nga organizatat joqeveritare, qeveritare dhe ndërkombëtare në shtetet e destinimit, tranzitimit dhe origjinës. Këta masa mund të përfshijnë – por nuk janë të kufizuara në – vendosjen, mbrojtjen mjekësore, ndihmë psikologjike, edukim, trajnime profesionale, punësim, ndihmë juridike dhe transportim.</p>
14. Ri-integrimi	Ri-integrimi i viktimate është bashkimi përsëri i tyre me familjen, komunitetin ose integrimi i tyre në komunitetin e ri. Përveç vetë aktit të kthimit, kjo gjithashtu, përfshin integrimin e viktimës në mjedisin social me zgjidhje afatgjate sociale dhe ekonomike.
15. Kthimi	Kthimi i një personi në shtetin e tij/ të saj dhe/ ose komunitetin e origjinës. Në kontekst të aktiviteteve për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, kthimi nuk domethënë vetëm transportim fizik të viktimës, por gjithashtu, edhe mekanizma të cilat sigurojnë kthim të sigurt dhe me dinjitet.
16. Livrues/ ofrues të shërbimeve	Personel profesional prej institucioneve dhe organizatave kompetente të cilat sigurojnë shërbime për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (punëtorë social, psikologë, pedagogë, juristë, punëtorë shëndetësor dhe të tjera).
17. Vendpranimi/ Qendër për vendosje	Objekte të cilat sigurojnë vendosjen e përkohshme të viktimate të mundshme dhe viktimate të trafikimit të qenieve njerëzore të llojit të hapur dhe të mbyllur dhe ofrojnë vendosje afatshkurte dhe/ ose afatgjate.
18. Mbrojtja e dëshmitarëve	Masat e sigurisë të nevojshme për sigurimin e sigurisë të viktimate gjatë procedurave gjyqësore. Mbrojtja e dtshmitarëve mund të ofrohet para, gjatë dhe/ose pas përfundimit të procedurës penale dhe mund të përfshijë një masa ose më tepër masa të parashikuara me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

LISTA E SHKURTESAVE (AKRONIMEVE)

APK	Aksion plani kombëtar
BZHA	Biro për zhvillimin e arsimit
DAP	Drejtoria e të Ardhurave Publike
DEIKK	Departamenti për emigrimin ilegal dhe krimin tejkufitar
EJL	Evropa Juglindore
GIZ	Shoqata gjermane për bashkëpunim ndërkombetar
GJTHSH1	Gjykata Themelore Shkup 1
IOM	Organizata ndërkombebare e emigrimit
IPA	Instrument për ndihmë para bashkëngjitjes
ISHP	Inspektorati shtetëror i punës
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Këshilli i Evropës
KK	Komisioni Kombëtar
KP	Kodi Penal
MARRI	Iniciativa rajonale për emigrim, strehim dhe refugjatë
MASH	Ministria e arsimit dhe shkencës
MD	Ministria e drejtësisë
MF	Ministria e financave
MKU	Mekanizmi kombëtar për udhëzim
MPB	Ministria e punëve të brendshme
MPJ	Ministria e punëve të jashtme
MPPS	Ministria e punës dhe politikës sociale
MSH	Ministria e shëndetësisë
MTU	Mekanizëm transnacional për udhëzim
NJTQNJK	Njësia për trafikimin e qenieve njerëzore dhe Kontrabandimin e emigrantëve
NJVL	Njësi të vetëqeverisjes lokale
OSBE	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
PDK	Përfaqësi diplomatike - konzullare
POS	Procedurat operative standarde
PP	Prokuroria Publike
QNPPM	Qendra ndërkombebare për përpilimin e politikave migruese
QPS	Qendra për punë sociale
QPVTQN	Qendra për Persona Viktimë të Trafikimit me Qeniet Njerëzore
RK	Raportuesi kombëtar
RM	Republika e Maqedonisë
SCE	Sekretariati për çështjet evropiane
SCKE	Sektori për çështjet kufitare dhe emigrimet
SHQ	Shoqata të qytetarëve
UE	Unioni Evropian
UNICEF	Fondi ndërkombetar për fëmijët i Kombeve të Bashkuara
UQM	Universiteti Qirili dhe Metodi

HYRJE

Qëllimi dhe metodologjia për përpilimin e Strategjisë kombëtare dhe Aksion planit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal për 2013 - 2016

Misioni dhe detyrat

Përpilimi i Strategjisë Kombëtare dhe Aksion Planit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal 2013 – 2016 është aktivitet i cili buron nga dedikimi i Qeverisë për përgjigje funksionale dhe efikase ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë obligohet për implementimin e suksesshëm të qëllimeve dhe detyrave strategjike të strategjisë kombëtare, sepse ata janë hapa thelbësore për pranimin e shtetit në Unionin Evropian.

Edhe përkundër avancimit të Republikës së Maqedonisë në përforcimin e sundimit të së drejtës, sigurisë dhe reformave institucionale, trafikimi me qeniet njerëzore mbetet formë e krimit të organizuar i cili paraqet rrezik për sigurinë dhe stabilitetin e Republikës së Maqedonisë e cila aktualisht paraqet shtet të origjinës, tranzitimit dhe shtet të destinimit.

Prandaj qëllimi i kësaj Strategjie Kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal është që të nxis mirëkuptimin e përbashkët për detyrat kryesore dhe vlerat thelbësore të të drejtave të njeriut në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Republikën e Maqedonisë. Misioni i saj është që të caktojë prioritetet strategjike në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, të definojë detyrat specifike dhe institucioneve/ organizatave përgjegjëse, si edhe t'i harmonizojë aktivitetet ndër – institucionale për arritjen e qëllimeve të caktuara, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar.

Misioni, gjithashtu, është që të sigurojë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të cilat ju livrohen viktimave dhe të intensifikohet investigimi (hetimi), ndjekja penale dhe dënim i keqbërësve. Aksion Plani Kombëtar ka për qëllim të planifikojë aktivitete të koordinuara të të gjitha palëve dhe akterëve të interesuar, por, edhe të sigurojë mbështetje të gjerë politike dhe financiare për implementimin e aktiviteteve të parashikuar me planin.

Aksion Plani Kombëtar përmban katë sfera: **korniza mbështetëse, prevenimi, mbështetja dhe mbrojtja e viktimave dhe emigrantëve dhe procedurën para hetuese dhe penale të trafikimit me qeniet njerëzore dhe kontrabandimin**



e emigrantëve. Në të janë caktuar qëllimet, rezultatet e pritura, aktivitetet e caktuara prioritare të institucioneve/ organizataave në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal, është përcaktuar korniza kohore për realizimin, janë theksuar treguesit dhe janë parashikuar implikimet fiskale. Më këtë që u tha është planifikuar zbatimi aktiv i politikave dhe gjetja e drejtimeve për përgjigje më efikase ndaj modaliteteve dhe tendencave të ndryshmë te trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimin ilegal.

1. Metodologjia e përpilimit

Strategjia kombëtare 2013 – 2016 dhe aksion Plani kombëtar ishin përpiluar nga Grupi punues Ndër-sektorial të formuar nga ana e Komisionit kombëtar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal, që është i përbërë nga përfaqësues të institucioneve qeveritare, organizataave qytetare dhe ndërkombëtare², në bazë të vlerësimit paraprak të realizuar për përmembushjen e strategjisë Kombëtaredhe Aksion Planit Kombëtar 2009 – 2012 nga ana e vlerësuesit të pavarur.

Duhet të theksohet se reformat juridike dhe aktivitetet e planifikuara nga ana e Qeverisë së republikës së Maqedonisë, kryesisht ishin të implementuara me sukses. Në bazë të këtyre hapave pozitive, Raporti për vitin 2009, 2011 dhe 2012 i përgatitur nga Departamenti Shtetëror i SHBA, mundësoi hyrjen e vendit në TIER 1 grupin e shteteve të cilat i përmembushin kushtet për luftë të suksesshme kundër trafikimit të qenieve njerëzore³. Gjithsesi, edhe më tutje duhet që të arrihet përparimdhë Qeveria e Republikës së Maqedonisë është tërësisht e vetëdijshme për nevojën për avancimin e mëtutjeshëm të aktiviteteve për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal.

Me këtë Strategji kombëtare është implementuar përpjekjen e Komisionit Evropian me të cilën vendoset përqendrimi në masat konkrete të cilat do të mbështesin implementimin e Direktivës për pengimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal dhe mbrojtjen e viktimate të saj⁴ 2011/36/EU. Direktiva përveç të tjera parashikon sanksionimin e fuqizuar të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet të marrjes së pronësisë të fituar në mënyrë joligjore për personat me dënim fuqipolë për vepër penale trafikim të qenieve njerëzore.

Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal 2013 – 2016 është përpiluar edhe sipas eksperiencës së

² Shiko anëtarët e rupit Punues në Shtojcën II.

³ Sipas metodologjisë të shfrytëzuar në TIP raportin, shtetet mund të vendosen në Tier 1, Tier 2 (lista pasqyruese) ose Tier 3. Tier 1 shtetet qeveritë e të cilave në tërësi përmembushin standardet ndërkombëtare për çrrënëzimin e trafikimit me qeniet njerëzore, Tier 2 shtetet qeveritë e të cilave nuk i përmembushin standardet ndërkombëtare, por bëjnë përpjekje të rëndësishme që t'i realizojnë ata, Tier 3 shtetet qeveritë e të cilave nuk i përmembushin standardet minimale, dhe nuk bëjnë përpjekje që t'i realizojnë të njëjtat.

⁴ Direktiva 2011/36/EU për pengimin dhe luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore dhe mbrojtja e viktimate prej saj, OJ 15.04.2011, L 101.

fituar në implementimin e politikave dhe masave të mëparshme në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal nga institucionet kombëtare, organizatat ndërkombëtare dhe shoqatat e qytetarëve, përgjegjëse për implementimin. Aplikimi i parimeve të transparencës dhe pjesëmarrjes të të gjitha palëve të interesuara përgjegjëse për implementimin është me rëndësi të jashtëzakonshme në përpjekjet për arritjen e rezultateteve të planit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë. Pjesëmarrja e përbashkët në përpilimin e Strategjisë dhe APK mundëson dhe obligon përfshirjen e tyre aktive në implementimin e aktiviteteve në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Ishin marrë në konsiderim edhe analizat edhe rekomandimet prej Raportit të UE për avancimin e shtetit për vitin 2011 dhe Raporti i Departamentit shtetëror të SHBA për vitin 2011 për trafikimin e qenieve njerëzore, Strategjia e UE për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2009 – 2012, rekomandimet e Koordinatorit kombëtar dhe Raportuesit kombëtar, rekomandimet e fituara nga vlerësimi i realizuar të APK për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal për vitin 2009 – 2012 dhe APK për luftën kundër trafikimit me fëmijë dhe praktikat e mira të adoptuara në përpilimin e dokumentit nga ana e anëtarëve të Grupit punues me ekspertizë teknike të siguruar nga ana e GIZ⁵.

Kontribut në përpilimin e strategjisë kombëtare dhe APK dhanë edhe hulumtimet e gjera sistematike dhe analizat e zbatuara me mbështetjen e GIZ në vitin 2012, të cilat kanë të bëjnë me: kornizës ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare për tejkalimin e varfërisë me fokus të veçantë në trafikimin e qenieve njerëzore, vlerësimi i varfërisë dhe hartimi i grupeve të ndjeshme me fokus të veçantë në trafikimin e qenieve njerëzore dhe programet kombëtare dhe përfitimet në kuadër të sistemit të mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë. Të njëjtat i definojnë edhe pikat kyçë për përcaktimin e prioriteteve, politikave dhe aktiviteteve strategjike dhe metodologjinë për përpilimin e Strategjisë kombëtare dhe Aksion Planin kombëtar.

2. Karakteristikat kyçë inovative të Strategjisë kombëtare për vitin 2013 – 2016 dhe Aksion Plani kombëtar për luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal

Fokusi i Strategjisë kombëtare dhe Aksion Planit kombëtar për 2013 – 2016 është në përputhje me Strategjinë e UE për çrrënëzimin e trafikimit të qenieve njerëzore 2012 – 2016.

⁵ Komisioni evropian, raporti për avancimin, SEC (2008) 2695, 5 nëntor 2008; Departamenti Shtetëror i SHBA,TIP Raporti 2008.

Strategjia e UE identifikon **pesë prioritetet** në të cilat duhet të fokusohet Strategjia kombëtare në ballafaqimin me problemin e trafikimit të qenieve njerëzore. Përpiqet për aksione të përbashkëta të të gjithë akterëve, përfshirë këtu edhe organizatat ndërkombëtare, shoqërin qytetare dhe sektorin privat. Në këtë drejtim si aktivitete prioritare i thekson si vijon:

- Identifikimi, mbrojtja dhe ndihma e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore;
- Fuqizimi i parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore;
- Ndjekje penale më e madhe e trafikantëve me qeniet njerëzore;
- Koordinim dhe bashkëpunim i rritur midis akterëve kyç dhe harmonizim të politikës;
- Njohuri më të mëdha dhe përgjigje efektive ndaj problemeve të reja të shfaqur të cilat kanë të bëjnë me të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore.

Strategjia kombëtare 2013-2016 dhe Aksion Plani kombëtar i Republikës së Maqedonisë shfrytëzon politikën tanimë të vendosur e cila jep praktika të mira në zbatimin e e Strategjisë kombëtare dhe Aksion Planeve të përparshëm, ndërsa në të njëjtën kohë jep drejtime në zhvillimin e *qasjeve të reja ligjore dhe institucionale* në ndjekjen e natyrës së ndryshueshme të trafikimit të qenieve njerëzore.

2.1 Karakteristikat kyçe inovative të Strategjisë kombëtare dhe Aksion Plani kombëtar

Edhe pse deri tani lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore para së gjithash përqendrohej në trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim të ekspluatimit seksual, Qeveria e Republikës së Maqedonisë e shqyrton nevojën për një spektër më të gjerë të aktiviteteve në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, me qëllim që të përfshin edhe format e tjera të saj, në veçanti *eksploatimin e punës, kërkuarjen lëmoshë dhe martesat e detyrueshme*.

Rëndësi e veçantë i është dedikuar çështjes së trafikimit të fëmijëve, në pajtim me rekomandimet e dhëna nga ana e Nëngrupit të luftës kundër trafikimit të fëmijëve.

Në kuadër të **Kornizës mbështetëse**, karakteristikat kyçe inovative janë:

- *Formimi i Komisioneve lokale për trafikimin me qeniet njerëzore në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes lokal;*
- *Vendosja e ekipeve të lëvizshme në nivel lokal për identifikim, ndihmë dhe mbështetje të viktimave potenciale dhe grupeve të rezikut;*

- *Sigurimi i mbrojtjes shëndetësore falas dhe nbrojtjes juridike falas për viktimat e trafikimit me qeniet njerëzore;*
- *Themelimi i fondit shtetëror për dëmshpërbimin e viktimateve;*
- *Viktimat potenciale të identikuara të trafikimit me qeniet njerëzore midis emigrantëve ilegal;*
- *Themelimii bazës së centralizuar të dhënave për viktimat dhe keqbërësit me të dhëna të siguruara lidhur me dimensionin gjinor të trafikimit me qeniet njerëzore.*

Në kuadër të **Parandalimit** karakteristikat kyçë inovative janë:

- *Organizimi i fushatave për reduktimin e kërkësës për shfrytëzimin e shërbimeve prej viktimateve të trafikimit me qeniet njerëzore/fëmijët;*
- *Fuqizimin ekonomik të grupeve të ndjeshme për lehtësimin e qasjes deri te tregu i punës (kualifikim shpeshtë, ri-kualifikim, punësim).*

Në kuadër të **Mbështetjes së viktimateve dhe emigrantëve** karakteristikat kyçë inovative janë:

- *Efikasiteti i shtuar në identifikimi, udhëzimin dhe mbrojtjen nëpërmjet të përpilimit të treguesve të viktimateve të trafikimit me qeniet njerëzore/fëmijët sipas llojeve të ekspluatimit.*

Në kuadër të **Procedurës para-hetimore të trafikimit me qeniet njerëzore dhe kontrabandimit të emigrantëve** karakteristikat kyçë inovative janë:

- *Realizimi i suksesshëm i investigimeve ndërkombëtare nëpërmjet të themelimit të EPI (ekipeve të përbashkëta investiguese) për trafikimin me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal.*

Monitorimi dhe vlerësimi objektiv i implementimit adekuat të aktiviteteve të planifikuara është pjesë përbërëse e strategjisë dhe pjesa kyçë e suksesit të saj.

3. Fuqizimi i veglave dhe politikave tanimë ekzistuese

Koordinimi i fuqizuar midis institucioneve për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në nivel qendror dhe lokal dhe fuqizimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar

Karakteristika kryesore e APK në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal 2013 – 2016 është bashkëpunimi midis institucioneve në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në nivel qendror dhe lokal.

Roli koordinues i fuqizuar i të gjitha aktorëve të ngërthyer në involvimin e aktiviteteve në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore me koordinim të

fuqizuar midis nivelit qendror dhe lokal. Për koordinim në nivel lokal formohen këshillat lokale.

Qeveria, gjithashtu, përpinqet për fuqizimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit bilateral dhe rajonal me shtetet fqinje – në veçanti midis institucioneve për zbatimin e ligjit dhe pushtetin gjyqësor – sepse një strategji efikase në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore para së gjithash mbështetet në bashkëpunimin ndërkombëtar të fuqishëm operativ dhe strategjik. Në atë drejtim do të nënshkruhen protokollë midis shteteve nënshkruuese të Konventës së Vjenës, marrëveshje për ri-admisim dhe protokollë për implementim si edhe takime rajonale dhe vizita studimore me qëllim të këmbimit të praktikave të mira.

Fokusi i fuqizuar në identifikimin dhe programet të akomoduar individualisht për pengimin e viktinizimit sekondar

Aktivitetet e parashikuar me APK për 2013 – 2016 do t'i përmirësojnë procedurat ekzistuese për identifikimin e viktimate të trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal nëpërmjet të **profesionistëve të aftësuar kompetent**.

Do të përforcohen kapacitetet në nivel lokal dhe koordinimi midis institucioneve duke përfshirë edhe sektorit qytetar me vendosjen e ekipeve të lëvizshme në nivle lokal për identifikim, *ndihmë dhe mbështetje të viktimate potenciale dh grupeve të rrezikut*.

Qeveria do të përpinqet për përmirësimin e mëtutjeshëm të mbrojtjes së viktimate në periudhën e qendrimit, me çka do të mundësojë që secila viktimë të fitojë ndihmë juridike falas dhe mbrotje shëndetësor falas.

Planet individuale për ndihmë do të akomodohen sipas nevojave të secilës viktimë, me qëllim që të mundësohet proces i suksesshëm i rehabilitimit dhe ri-integrimit.

Mekanizmat për kompensim do të janë tërësisht efektiv me miratimin dhe implementimin e Ligjit për fodnin shtetëror për dëmshpérblimin e viktimate.

Qeveria obligohet të realizojë programe praktike për *fuqizimin ekonomik të viktimate* me lehtësimin e qasjes deri te tregu i punës nëpërmjet të kualifikimit shësë, rikualifikimit dhe punësimit të anëtarëve të grupeve të ndjeshme.

Avancimi i procedurës investiguse dhe përpjekjet për ndjekje penale – MPB

Rregullativa ligjore për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore vazhdimisht po zhvillohet në vitet e kaluara dhe ofron kornizë efikase në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Përveç kësaj, Qeveria ndërmorri masa për fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve kompetente për ndjekjen e keqbërësve.

Me ndryshimet e Ligjit për Prokurorinë Publike është themeluar Prokuroria Publike Themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korruptionit, si edhe ndryshimet në Ligjin për Gjykatat përgjegjësisnë për ndjekjen e veprave penale në sferën e trafikimit të qenieve njerëzore i është shënë Gjykatës Themelore Shkupi 1, me çka mundësohet specializimi dhe efikasitet më i madh në udhëheqjen e procedurave. Me miratimin e Ligjit të ri për procedurë penale në nëntor të vitit 2010 procedura investiguese ju dha në besim prokurorisë Publike, themelohet Policia Gjyqësore e cila është përgjegjëse për zbulimin e veprave penale dhe keqbërësve, gjë e njëjtë që në mënyrë funksionale është e nënshtuar pranë Prokurorisë Publike.

Me këta ndryshime thelbësore pritet përmirësimi i cilësisë së investigimeve të cilat do t'i realizojë Policia Gjyqësore në bashkëpunim direkt me Prokurorinë përkatëse Publike.

Masat e veçanta investiguese si vegël juridike gjatë udhëheqjes së investigimeve nga ana e Prokurorisë Publike dhe Policisë gjyqësore do të mundësojnë sigurimin e dëshmive cilësore kundër keqbërësve.

Aktivitetet për ngritjen e qëndrueshme të kapaciteteve parashikohen me Aksion Planin Kombëtar të ri në kuadër të institucioneve kompetente për trajni – siç është Akademia për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve – me qëllim të tejkalimit të mangësive ekzistuese logjistike dhe shfrytëzimin joadekuat të dispozitave ligjore ekzistuese, në veçanti në lidhje me shfrytëzimin e masave speciale tanimë ekzistuese për investigim dhe mbrojtjen e dëshmitarëve⁶. Aksion plani i ri, gjithashtu, përfshin masa kyçë me të cilat përforcohet statusi i viktimës gjatë procedurës gjyqësore.

4. Orientimet strategjike të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e parandalimit, mbrojtjes, kthimit të sigurt në atdhe dhe rehabilitimit të viktimave të trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal sipas Aksion planit kombëtar për 2013 - 2016

Tendenca e trafikimit me qeniet njerëzore në Republikën e Maqedonisë në periudhën e kaluar tregon ndryshime të rëndësishme në numrin dhe profilin e personave të trafikuar në/ nëpërmjet dhe nga territori i Republikës së Maqedonisë. Duhet t'i kushtohet vëmendje në studimin e llojeve “të reja” të trafikimit me qeniet njerëzore, përfshirë këtu eksplloatimin në punë, kërkimin lëmoshë dhe kurrorëzimin e detyrueshëm sepse numri më i madh i viktimave të identifikuara janë viktimat të “llojeve të reja” të trafikimit me qeniet njerëzore me njerëz të cilët në të njëjtën kohë janë edhe persona të mitur.

⁶ Shiko rapporti i avancimit i UE për vitin 2008; Koalicioni të gjithë për gjykim të drejtë, “trafikimi i qenieve njerëzore dhe emigrimi ilegal shikuar nga ana e ahtrëeve kyç në procedurën penale”, dhjetor 2008.

Orientimet strategjike të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e parandalimit përqendrohen në: Identifikimin e arsyeve të paraqitjes së fenomenit të trafikimit me qeniet njerëzore/ fëmijë dhe emigrimin ilegal edhe në atë drejtim do të zhvillohet hulumtimi dhe analiza për identifikimin e rreziqeve dhe grupeve të rrezikuara për trafikimin me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal me fokus te fëmijët, me çka edhe do të vendosen prioritetet për përmirësimin e aktiviteteve për prevenim. Ngritja e vetëdijes publike lidhur me trafikimin e fëmijëve dhe fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve/ organizatave kompetente si edhe medias për realizimin e aktiviteteve parandaluese do të zbatohen nëpërmjet të trajnimeve. Ngritja e vetëdijes publike do të realizohet nëpërmjet të fushatave për zvogëlimin e kërkesës për shfrytëzimin e shërbimeve prej viktimave të trafikimit me qeniet njerëzore/ fëmijët. Parandalimi do të përfshijë edhe masat specifike për fuqizimin ekonomik të grupeve të ndjeshme për qasjen deri te tregu i punës me kualifikim shështë, rikualifikim dhe punësim.

Mbrojtja e viktimave dhe emigrantëve do të përmirësohet me sigurimin dhe implementimin e bazës ligjore për ndihmës juridike falas të viktimave të trafikimit me qeniet njerëzore dhe sigurimit të shërbimeve sociale të vazhdueshme të viktimave të trafikimit me qeniet njerëzore, si edhe miratimin e Ligjit për fondin shtetëror për dëmshpërblimin e viktimave.

Ndihma dhe mbrojtja direkte e viktimave dhe emigrantëve do të jepet në Qendrën për personat viktima të trafikimit me qeniet njerëzore dhe Qendrën e pranimit për të huaj, ku do t'ju sigurohet pako standarde e shërbimeve për nevojat themelore, ndihmë juridike, shëndetësore dhe psiko-sociale dhe inkudrimi në procesin arsimor.

Integrimi i viktimave të trafikimit me qeniet njerëzore/ fëmijët në mjediset sociale do të realizohet nëpërmjet të përpilimit të programit të unifikuar për ndihmë, mbështetje dhe ri-integrim të viktimave të trafikimit me qeniet njerëzore dhe revidimin e programit për ri-integrim dhe resocializimin e fëmijëve, si edhe nëpërmjet të zhvillimit të formave alternative të mbrojtjes.

Në kontekst të mbrojtjes së viktimave dhe emigrantëve ilegal do të sigurohen mjete për ri-atdhesimin e tyre. Kthimi i sigurt i viktimave të huaj të trafikimit me qeniet njerëzore do të realizohet me ndihmën e organizatave ndërkombëtare në shtetet amë.

Do të përpilohen kriteret për zgjedhjen e shoqatave të qytetarëve të cilat do të inkudrohen në mbrojtjen e viktimave të trafikimit me qeniet njerëzore/ fëmijët dhe të njëjtët do të jenë partnerë të institucioneve në sigurimin e shërbimeve të përmendura.

I. PARIMET KRYESORE TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE AKSION PLANIT KOMBËTAR PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT ME QENIET NJERËZORE DHE EMIGRIMIT ILEGAL

Strategjia kombëtare dhe APK për vitin 2013 – 2016 tërësisht janë në përputhje me parimet kyçë të cilat e rregullojnë implementimin e Rezolutës qeveritare për politikat emigruese në Republikën e Maqedonisë 2009-2014⁷, e ndjekin strukturën e bazuar në standardet ndërkombëtare dhe standardet e UE⁸, strategjinë e UE për 2013 – 2016 dhe Modelet e aktiviteteve gjithëpërfshirëse në luftën kundër trafikimi me qeniet njerëzore prej QNPPM⁹.

Parimet udhëheqëse pasqyrohen nëpërmjet të sferave dhe qëllimeve strategjike të definuar sipas katër komponenteve kryesore të aktiviteteve në luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore, gjegjësisht **kornizës mbështetëse, parandalimit, mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave dhe emigrantëve dhe procedures para hetuese dhe penale të trafikimit me qeniet njerëzore dhe kontrabandimin e emigrantëve.**

Parimi i 1-rë. Përgjegjësia e Qeverisë për Strategjinë

Qeveria e Republikës së Maqedonisë **merr përgjegjësinë dhe kompetencën e plotë** në përcaktimin e qëllimeve, implementimit të aktiviteteve dhe arritjes së rezultateteve prej aktiviteteve të realizuara si përgjigje kombëtare ndaj problemit të trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimit ilegal.

Përgjegjësia e Qeverisë edhe në periudhën e ardhshme është që të kryejë shpërndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e shërbimeve juridike, shëndetësore dhe sociale të viktimave të trafikimit me qeniet njerëzore. Gjithashtu është e nevojshme që të merret në konsiderim rënia e mbështetjes financiare nga ana e komunitetit ndërkombëtar dhe sigurimit në kohë të duhur të qëndrueshmërisë për realizimin e aktiviteteve në luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore.

⁷ Sipas kësaj rezolute, politika migruese e shtetit udhëhiqet sipas parimeve kyçë vijuese:

- Konzistенca – harmonizimi i politikave specifike (politikat për menaxhimin e proceseve migruese; politika e cilës prek diasporën; politika imigruese; politika për mbrojtjen e refugjatëve; strehimi politik, politika e integrimit) midis tyre edhe me politikën migruese në aspektin e gjerë;
- Kompatibiliteti – harmonizimi i politikës migruese me politikën ekonomike, sociale, demografike dhe kulturore në Republikën e Maqedonisë. Verifikimi i masave të miratuara midis qëllimeve të politikave të lartpërmendura, efikasiteti i masave të miratuara, ndikimi i politikës migruese dhe akomodimi i ndryshimeve në proceset migruese;
- Transparency – në implementimin e politikave të dhëna dhe politikës së përgjithshme migruese të procedurave administrative dhe tatimeve publike, me qëllim të fitimit të besimit dhe mbështetjes publike;
- Qëndrueshmëri – në aspektin e planit, përgatitjes dhe monitorimit të implementimit të politikës migruese.

⁸ Aksion Plan i UE për praktikat, standardet dhe procedurat më të mira për shpartallimin dhe parandalimin e trafikimit me qeniet njerëzore, OJ C 311, 9 dhjetor 2005, faqe 1.

⁹ QNPPM "Udhëzuesi për përpilimin dhe implementimin e luftës më të gjerë kundër trafikimit të qenieve njerëzore", Programi evropian përfshirë fuqizimin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Evropën Juglindore, 2006 në dispozicion në <http://www.anti-trafficking.net>.

Prandaj, është e nevojshme që të sigurohetqëndrueshmëria e aktiviteteve për luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore nëpërmjet të mobilizimit të shtuar të resurseve njerëzore dhe financiare, si edhe trajnimet e vazhdueshme të cilat do të mundësojnë rritjen e qëndrueshmërisë së diturive me të cilat do të fuqizohen kapacitetet e institucioneve/ organizatave kompetente për implementimin e aktiviteteve.

Parimi i 2-të. Pjesëmarrja e sektorit qytetar

Lufta kundër trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimit illegal nuk është përgjegjësi tërësisht vetëm e institucioneve të Qeverisë. Qeveria e Republikës së Maqedonisë konfirmon se edhe përpilimi edhe implementimi i programeve dhe masave në luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore duhet detyrimisht të inkuadrojë edhe palët e interesuara të cilat janë të pavarura nga shteti dhe të cilat janë jashtë administratës qeveritare dhe publike, Shoqatat e qytetarëve luajnë rol aktiv në *implementimin e hulumtimeve dhe analizave, zbatimin e aktiviteteve parandaluese, sigurimin e ndihmës dhe mbështetjes për viktimat në Vendpranimet dhe në procesin e reintegrimit në mjedisin social*.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë obligohet që të ndërtojë marrëdhënie partnerë me Shoqatat e qytetarëve të cilat tregojnë siguri dhe profesionalizëm nëpërmjet të përpilimit të kriterieve për selektimin e shoqatave të qytetarëve të cilat do të janë të inkuadruar në ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit me qeniet njerëzore.

Parimi i 3-të. Trajtimi i viktimave i bazuar në të drejtat e njeriut

Strategjia kombëtare në luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore në mënyrë normative dhe operative mbështetet në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti të atyre të përfshira në Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive elementare, si edhe protokollëve gjegjës¹⁰.

- E drejta në jetë (neni 2);
- E drejta për të mos qenë i nënshtruar në tirturim, trajtim jonjerëzor dhe degradues (neni 3);
- Ndalimi i skllavërisë dhe punës së dhunshme (neni 4);
- E drejta për të mos qenë i mbajtur peng në mënyrë joligjore (neni 5)
- E drejta e gjykimit korrekt (neni 6)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë konfirmon se mekanizmat kombëtare për identifikim, mbrojtje dhe udhëzim të viktimave, si edhe e tërë procedura gjyqësore, tërësisht janë në pajtim me këtë qasje të të drejtave të njeriut. Qeveria

¹⁰ Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive elementare, përpiluar në Romë, 4. XI.1950, Vargu i kontratave të Këshillit të Evropës nr. 44.

e Republikës së Maqedonisë përpinqet kah *avancimi i mëtutjeshëm për mbrojtjen e të drejtave të viktimave* në drejtim të sigurimit të informatave juridike, mbrojtjes fizike dhe juridike, ndihmës materiale dhe kompensimit të cilat dërgojnë kah mundësimi i integrimit dhe rehabilitimit tq qëndrueshëm të tyre në shoqëri.

Parandalimi i trafikimit me fëmijë dhe mbrojtja adekuate është prioritet i vazhdueshëm i Qeverisë dhe është identifikuar si njëra nga sifdat kyçë për periudhën vijuese.

Parimi i 4-të. Koordinimi ndër-disiplinor dhe qasje participative

Masat e inkuadruara në Aksion planin kombëtar 2013-2016 realizohen nëpërmjet të pjesëmarrjes aktive të palëve të interesuara në implementimin e saj.

Për realizimin e suksesshëm të masave të planifikuara nevojitet **koordinimi interdisiplinor me kombinimin e njohurove dhe profesionalizmit me çka sigurohet qasja participative e disiplinave të ndryshme**. Qeveria është përgjegjëse për promovimin dhe koordinimin e përpjekjeve multi-institucionale dhe gjithpërfshire e pjesëmarrjen aktive të të gjitha palëve të interesuara në implementimin e saj.

Parimi i 5-të. Qëndrueshmëria

Strategjia Kombëtare wshtw e konceptualizuar si platforme e qwllimeve dhe detyrave tw qarta, mirw tw definuar dhe reale tw cilat dwrgojnw kah pjeswmarrja aktive e tw gjitha palve tw interesuara nw implementimin e saj.

Qeveria wshtw wrsjegjwse pwr pwrrpilimin e sistemit tw monitorimit i cili e vlerwson implementimin e APK, si nga perspektiva kuantitative ashru edhe nga ajo kualitative.

Kjo siguron që *strukturat dhe veglat të durojnë nëpër tërë periudhën nëpërmjet të shpërndarjes të resurseve përkatëse financiare dhe njerëzore, të akomoduara sipas kushteve të ndryshueshme*.



II ANALIZA E GJENDJES DHE VLERËSIMI I KORNİZËS EKZISTUESE INSTITUCIONALE

1. Tendencat e Trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigimin ilegal në Republikën e Maqedonisë

Analiza e gjendjes

Analiza e gjendjes së tanishme është e drejtuar kah sigurimi i fotografisë gjithpërfshirëse të tendencave të trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë. Sipas hulumtimit e realizuara deri tani prej palëve të interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare, në vazhdim vlerësohet se trafikimi me qeniet njerëzore brengos më së tepërti në shtetet me ndjeshmëri sociale të viktimate si faktor kryesor. Ndjeshmëria buron nga faktorët ekonomik dhe social, siç janë varfëria, diskriminimi gjinor, dhuna në familje dhe gjendje të tjera të ndryshme personale të viktimës (siç janë mosha, gjendja shëndetësore, nevojat e veçanta).

Statistika dhe hulumtimet tregojnë se vendi momentalisht po ballafaqohet me evoluimin në aspekt të natyrës dhe tendencave të trafikimit me qeniet njerëzore. E kundërta nga gjendja e shtetit në vitin 2004 ku numri më i madh i viktimate ishin shtetas të huaj, pas kritës në Kosovë mund të vashtrohet numër i reduktuar i viktimate me origjinë të huaj dhe rritje e numrit të viktimate dhe fëmijëve nga vendi që trafikohen brenda shtetit, më së shpeshti të rekrutuar nga mjediset rurale lindore me qëllim të ekspluatimit të tyre në mjediset urbane në Maqedoninë perëndimore¹¹. Me të vërtetë, gjendja mdryshoi pas vitit 2007, pasi që atraktiviteti i Maqedonisë si destinim i dëshiruar u zvogëluar me integrimin në UE të disa shteteve të cilat llogariteshin si “burime tradicionale” (Romania dhe Bullgaria) dhe zhvillimit ekonomik të disa shteteve të tjera të Evropës lindore.

Duke analizuar periudhën 2008 – 2012 të rasteve të zbuluara të trafikimit me qeniet njerëzore dhe kontrabandimin e emigrantëve mund të konstatohen karakteristikat vijuese:

Në pjesën e trafikimit me qeniet njerëzore karakteristike është trafikimi i brendshëm, viktimat që në numër më të madh janë në moshë të mitur prej 14 – 17 vjeçar. Mënyra e rekrutimit është nëpërmjet të mashtrimit me premtimet e rrejshme për punësimë legale në objekte hotelierike. Viktimat më së shpeshti vijnë nga pjesa lindore dhe qendrore e Maqedonisë. Ekspluatimi kryhet në objektet hotelierike në pjesën perëndimore të Maqedonisë, Tetovë, Gostivar dhe

¹¹ IOM, raporti rajonal, raporti i dytë vjetor përviktimat e trafikimit me qeniet njerëzore nga shtetet e Evropës Juglindore, 2005.

Kérçovë. Trafikantët në bunrim më të madh të rasteve janë edhe pronarë të objekteve hoteliere ose bashktpunëtorë të tyre. Eksplotimi bëhet nëpërmjet të prostitucionit me dhunë dhe eksplotimit në punë në vetë objektet hoteliere.

Karakteristike është tendenca e re e trafikimit me qeniet njerëzore nëpërmjet të martesave me dhunë ose me marrëveshje. Viktimat janë kryekëput nga përkatësia etnike rome që është e lidhur dhe bart rrënjet nga e drejta tradicionale e zakoneve midis romëve që të bëhet marrëveshje për martesën ose e ashtuquajtura "nuse me porosi" dhe janë vetëm të mitur të moshës prej 14 – 17 vjeç dhe janë të përfaqësuar në të gjitha zonat e Republikës së Maqedonisë. Trafikantët ose porositësit e nuseve më së shpeshti janë nga Serbia, por edhe nga Republika e Maqedonisë të cilët ndodhen më punë të përkohshme në shtetet e UE.

Pas arritjes së viktimës në shtetin e destinimit ajo është e nënshtruar në dhunim, malltretim dhe dënim fizik prej anëtarëve të familjes së djalit, me qëllim që më vonë të jetë e eksplotuar edhe seksualisht edhe me punë.

Gjithashtu në tendencën e rritjes është edhe trafikimi me qëllim të eksplotimit në punë të meshkujve të mitur dhe viktima të moshuar nga Republika e Maqedonisë dhe shqipërisë, si barrinj të kopeve nga pjesa perëndimore e Republikës së Maqedonisë. Gjithashtu janë identifikuar edhe raste të eksplotimit në punë të punëtorëve tonë ndërtimor në vendndërtimet jashtë Republikës së Maqedonisë (rasti i Azarbejxhanit).

Në pjesën e emigrimit ilegal mund të konstatohet tendenca si vijon:

Republika e Maqedonisë me pozitën e saj gjeografike që lidh lindjen me perëndimin mbetet vend tranzit për emigrant ilegal. Si vende të origjinës të emigrantëve ilegal më së shpeshti paraqiten Afganistani, Pakistani, vendet e lindjes së afërme, të largët dhe Afrikës Veriore.

Hyrja e emigrimit ilegal është vetëm nga Greqia, e më së shpeshti zona e Gjevgjelisë dhe mjedisi më i afërt. Dalja më së shpeshti është nga Serbia nëpërmjet të vendkalimeve ilegale në komunën e Likovës, fshatrat Vaksincë dhe Lojane paraqitet si vendpranimet ilegale para braktisjes ilegale të territorit të Republikës së Maqedonisë. Në kohë të fundit është hapur një degë e re nga kosova, me qëllim që të vazhdojë kah Mali i Zi, BdheH dhe Kroacia. Tranziti nëpër Republikën e Maqedonisë bëhet në mënyrë të organizuar nga ana e grupeve kriminele më së shpeshti nga zona e shkupit, Kumanovës dhe Gjevgjelisë. Një tendencë e re është tranzitim i organizuar nga ana e udhëzuesve nga Afganistani dhe pakistani të cilët janë emigrantë ilegal dhe janë të detyruar nga ana e grupeve kriminele në bazë të borxhit në para për kontrabandimin që të punojnë si udhërrëfyes të emigrantëve për një periudhë te caktuar. Transporti më së shpeshti bëhet me automjete motorike për udhëtarë, autobusë të rregullt në linjën Gjevgjeli – Shkup – Kumanovë dhe linjat e rregullta të hekurudhës së Maqedonisë.

2. Korniza institucionale për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Bashkëpunimi midis faktorëve të ndryshëm mundet më së miri të sigurohet nëpërmjet të mekanizmave dhe procedurave të zyrtarizuara të cilat do të krijojnë dedikim dhe ndarje të qartë të roleve dhe detyrave të institacioneve që janë përfshirë.

2.1 Mekanizmat institucional mështetëse qeveritare

Nga viti 2001 Republika e Maqedonisë ka krijuar mekanizma speciale institucionale për luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore. Ata janë të orientuara kah sigurimi i koordinimit të lartë të palëve të ndryshme të interesuara dhe qasja në të cilën viktima është në plan të parë në luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore.

- Komisioni kombëtar për luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimit ilegal**

Komisioni kombëtar është organ ndër-ministror i përbërë prej përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së punëve të Jashtme, Ministrisë për punë dhe politikë sociale, Prokurorisë Publike themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, Gjykatës nga Gjykata themelore Shkup¹², Ministria e drejtësisë, Ministria e arsimit dhe shkencës, Ministria e shëndetësisë, Drejtoria e doganave të Republikës së Maqedonisë.

Komisioni kombëtar është formuar nga Qeveria në vitin 2001a¹³, me detyrë që të kryejë:

- Monitorimin dhe analizën e gjendjes së trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal;
- Koordinimin e aktiviteteve të institacioneve kompetente qeveritare;
- Bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare relevante dhe Shoqatat e qytetarëve.

- Sekretariati i Komisionit Kombëtar**

I formuar në vitin 2003 nga ana e Komisionit kombëtar dhe paraqet organin e tij ekzekutiv i cili punon nën përgjegjësinë e Komisionit dhe përgjigjet për pranimin dhe implementimin e vendimeve të Komisionit Kombëtar.¹⁴

¹² Ndërrimet e anëtarëve të Komisionit Kombëtar të shpallura në Gazetën zyrtare të RM nr. 32/2011

¹³ Vendimi i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, nr. 18/2001

¹⁴ Në Sekretariat marrin pjesë përfaqësuesit të organizatave ndërkombëtare, shoqatave të qytetarëve dhe ekspertë nga institucionet joqeveritare: MPB-NJLKTNJKE, MPSS-MKU, Ambasada e Amerikës, QNPPM, OSBE, GIZ, UNICEF, IOM, Qendra rajonale – MARRI, Shoqatat e qytetarëve: "Porta e hapur", "Për fëmijëri të lumtur", "Semper", "Ezerka" – Strugë dhe Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë.

- **Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijët**

Nëngrupi për luftën kundër trafikimit me fëmijët është formuar në vitin 2003 në kuadër të Komisionit Kombëtar. Aktivitetet e këtij organi janë fokusuar në parandalimin e trafikimit me fëmijë dhe përmirësimin e mbrojtjes së viktimave të mitura, si edhe koordinimi i bashkëpunimit midis palëve të interesuara.¹⁵

- **Raportuesi kombëta në Republikën e Maqedonisë**

Në Republikën e Maqedonisë **Raportuesi Kombëtar për trafikimin me qeniet njerëzore** është themeluar me propozimin e Komisionit Kombëtar, ndërsa i emërtuar nga Qeveria në vitin 2009¹⁶.

Sipas mandatit të tij Raportuesi Kombëtar është përgjegjës për:

- Mbikëqyrjen e aktiviteteve të përgjithshme për luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore;
- Grumbullimin dhe analizën e të dhënave (informata kuantitative dhe cilësore) nga partnerët relevant;
- Monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve të implementuara sipas APK;
- Miratimi i konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin dhe avancimin në luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore në aspekt të implementimit të ligjeve, politikave për përgjigje më të mirë institucionale dhe rekomandimet për revidimin e qëllimeve strategjike; dhe
- Përpilimi i raportit vjetor.

Deri tani Raportuesi Kombëtar ka përpiluar raporte për vitin 2009, 2010 dhe 2011 të cilat kanë të bëjnë me gjendjen e luftës kundër trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal dhe i janë dorëzuar Komisionit Kombëtar për luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal edhe deri te popullata e gjerë.

- **Zyra e Koordinatorit Kombëtar**

Zyra e Koordinatorit Kombëtar është e vendosur në kuadër të Ministrisë së punëve të brendshme dhe filloi me punë në prill 2007 me mbështetjen e misionit të OSBE-së me qëllim që të sigurojë mbështetje teknike dhe logjistike për Komisionin Kombëtar.

¹⁵ Me nëngrupin kryeson Këshilltari për mbrojtjen dhe prevenimin nga trafikimi me qeniet njerëzore nga MPPS-MKU, ndërsa anëtarësojnë përfaqësuesit e: MPB-NJLKTNKE, MPB-SÇKE, Ambasada e Amerikës, QNPPM, OSBE, GIZ, UNICEF, IOM, Shoqatat e qytetarëve: "Porta e hapur", "Për fëmijëri të lumtur", "Qasje e njëjtë" dhe ztvendts Avokati i popullit në rolin e anttarit të jashtëm/ mbikëqyrës.

¹⁶ (Vendimi i Qeverisë i shpallur në Gazeten Zyrtare të RM nr. 23, prej 19 shkurt 2009).

Zyra e Koordinatorit Kombëtar disponon me literaturë/bibliotekë të specializuar me publikime për trafikimin me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal për R. E Maqedonisë, shtetet e Evropës Juglindore, si edhe shtetet prej mbarë botës.

Në vitin 2009 zyra e Koordinatorit Kombëtar është institucionalizuar, me çka janë fuqizuar kapacitetet e Komisionit Kombëtar dhe Raportuesit Kombëtar në luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal.

• **Mekanizmi kombëtar për udhëzim (MKU)**


Baza e mekanizmave në luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore është Mekanizmi kombëtar për udhëzimin e viktimate të trafikimit me qeniet njerëzore që është themeluar në vitin 2005 me mbështetjen e misionit të OSBE-së në Shkup dhe punon në patronazhin e Ministrisë për punë dhe politikë sociale.

Mandati i Mekanizmit kombëtar për udhëzim është që të sigurojë identifikimin adekuat, ndihmë dhe mbrojtje, të bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për viktimat e trafikimit me qeniet njerëzore, në veçanti të personave të mitur dhe pa marrë oparasysh përkatësinë kombëtare, etnike, moshën ose gjininë. Mekanizmi kombëtar për udhëzim përfshin Zyrën Koordinuese dhe gjithsej 61 profesionistë prej 30 qendrave për punë sociale nëpër Maqedoni si edhe një përfaqësues të Entit për veprimtari sociale. Profesinistët nga Mekanizmi kombëtar për udhëzim bashkëpunojnë së afërm me MPB/NJLKTNKE, me përfaqësuesit relevant prej shoqatave të qytetarëve dhe palëve të tjerë të interesuara në procesin e udhëzimit dhe ndihmës të viktimate të trafikimit me qeniet njerëzore. Bashkëpunimi i suksesshëm mundëson sistem të udhëzimit pa mangësi¹⁷.

Në janar të vitit 2010, ishin përpiluar Procedurat Operative Standarde nën kompetencën e zyrës së Mekanizmit kombëtar për udhëzim, të cilat ishin të miratuara nga Qeveria, me qëllim që të dëfinojnë parimet, akterët dhe përgjegjësitë e tyre në proces e gjithëmbarshëm për ndihmë së bashkume udhëzimet për bashkëpunim midis akterëve në nivel lokal, kombëtar dhe trans-nacional.

¹⁷ Ministria e punës dhe politikës sociale e Republikës së Maqedonisë, projekt Mekanizmi Kombëtar për udhëzim, raporti përfundimtar për avancimin, 15 janar 2008.

Prezantimi skematik: Mekanizmat institucionale mbështetëse qeveritare



2.2 Institucionet dhe shërbimet Qeveritare të siguruara nga shoqatat qytetare

- Qendra për pranimin e të huajve/ Qendra për personat viktima të trafikimit me qenie njerëzore**

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë dy objekte në të cilat sigurohet pranimi dhe strehimi i viktimate të huaja dhe vendore të trafikimit me qenie njerëzore/fëmijë:

Qendra për pranimin e të huajve është objekt në pronësi të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë drejtuar nga Ministria e punëve të brendshme / Drejtoria për çështje kufitare e cila është në funksion prej prillit të vitit 2011 dhe i është dedikuar strehimit të shtetasve të huaj, viktima të supozuara dhe viktimate të trafikimit me qenie njerëzore dhe emigrantëve ilegal.

Në Qendrën për pranimin e të huajve të personave të strehuar, ekipi profesional¹⁸ siguron strehim, ndihmë dhe mbrojtje mjekësore, këshilla dhe përfaqësim juridik dhe mbështetje psiko-sociale, si edhe shërbime për kthim dhe reintegrim.

Prej vitit 2011, IOM siguron ndihmë të drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore¹⁹.

Qendra për personat viktima të trafikimit me qenie njerëzore (QPVTQN) ²⁰ është strehimore shtetërore e hapur me 28.01.2012 nga ana e MPPS në pajtim me obligimet të cilat dalin nga Ligji për mbrojtje sociale²¹.

Në Qendër strehoen viktimat e trafikimit me qenie njerëzore edhe atë shtetasit vendor dhe shtetasit e huaj të cilët kanë fituar lejen për qëndrim të përkohshëm. Në Qendrën për personat viktima të trafikimit me qenie njerëzore, ndihmë dhe mbështetje të drejtpërdrejtë jepin dy shoqatat qytetare me të cilët MPPS ka nënshkruan memorandum për bashkëpunim:

- mbështetje sociale nga shoqata qytetare “ Porta e hapur” dhe
- mbështetje psikologjike nga shoqata qytetare “ Për fëmijëri të lumtur”

Me rëndësi është që të theksohet se Qeveria e mbështet këtë strukturë me mbulim të shpenzimeve për siguri 24 orëshe, shërbime publike, plotësimin e nevojave themelore të përditshme për personat të cilët qëndrojnë atje.

Orientimet strategjike që kanë të bëjnë me përsosmërinë e kornizës institucionale dhe operative në suazat e Aksion Planit Kombëtar për vitet 2013-2016 zhguna

¹⁸ Ekipi profesional në Qendrën për pranim të huajve në vitin 2011 është përforcuar me punësim të psikologut dhe punëtorit social.

¹⁹ Burim: IOM Shkup, statistika për ndihmë viktimate të trafikimit me qenie njëzore – ndihmë e përgjithshme e drejtpërdrejtë e 785 viktimate nga trafikimi, nga të cilët 776 janë të huaj dhe 9 janë shtetas të maqedonisë.

²⁰ Burim: MPPS/MKU: prej hapjes deri në fund të gushtit të 2012 në Qendrën për personat viktima të trafikimit me qenie njerëzore janë strehuar 10 persona.

²¹ Gazeta Zyrtare e RM nr.79/09 n.26, n.31 dhe n.132

Në pajtueshmëri me parimet për përgjegjësinë e Qeverisë dhe nevojën për qëndrueshmëri të aktiviteteve për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore, Qeveria do të sigurojë:

- Kapacitete njerëzore dhe teknike adekuate dhe mbështetje financiare për avancim në fushën e trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandim të emigrantëve;
- Qeveria obligohet që të zhvillojë *koordinimin me pushtetet lokale*, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Maqedonisë;
- Qeveria, obligohet që të mbulon mungesën momentale të të dhënave të sakta statistikore përmes krijimit të bazës së centralizuar të të dhënave për viktimat dhe kryerësit.

Aktivitetet e përgjithshme në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore do të mbikqyren nga *Raportuesi Kombëtar* i cili është përgjegjës për grumbullim dhe analizë sistematike të të dhënave të cilat fitohen me anë të metodologjisë së zhvilluar (informata kualitative dhe kuantitative), si edhe bërjen e monitorimit dhe evaluimit të aktiviteteve të implementuara sipas APK.

3. Korniza juridike për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe politika e ndjekjes penale

- **Analiza e zhvillimit të kornizës juridike për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe politika e ndjekjes penale**

Vepra penale trafikim me qenie njerëzore ishtepërfshirë në legjislacionin e Maqedonisë me amandamente dhe plotësime të Kodit penal (25 janar 2012) si pjesë e nenit 418-a. Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit transnacional të organizuar dhe të dy Protokolet plotësuese të Palermos (viti 2000), si edhe Konventën e Këshillit të Evropës për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore, me të cilën e harmonizoi legjislacionin e vet kombëtar me standardet ndërkombëtare dhe krijoi një kornizë më të gjërë juridike për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore me përqëndrim të veçantë në fëmijët²².

Neni 418 i cili e definon veprën penale trafikim me qenie njerëzore u ndryshua në mars të vitit 2004. Amandamentet e 2004 kishin të bëjnë me paragraplin 1 nga neni 418-a, dhe ofrojnë listë të zgjeruar të formave të ekspluatimit sesa ato të parapara me Protokolin e Palermos si “*ekspluatim përmes prostitucionit ose të tjera forma të ekspluatimit seksual, pornografi, punë e detyruar ose robëri, skllavëri,*

²² Shiko Shtojën 1 Lista e instrumenteve vendor dhe ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore të cilët janë në fuqi juridike në Republikën e Maqedonisë.

martesa tē detyruara, mbarsje fekondim e/i detyruar, adoptim jashtëligjor, ose marrëdhënie tē ngjashme ose transplatim jolegal i organeve njerëzore”.

Në rastin kur viktimë është fëmija ose person i mitur, dënimini minimal është ritur dhe kryerësit do ti shqiptohet dënim me burg prej më së paku tetë vjet. Përveç kësaj, amandamentet e kriminalizojnë edhe angazhimin e personit juridik – në rast se i fundit e ka kryer veprën penale dhe gjithashtu parashohin marrjen e objekteve dhe mjeteve transportuese me të cilët është kryer vepra penale.

Amandamentet e vitit 2004 tē Kodit penal tē Maqedonisë, si plotësim në përfshirjen e veprës penale trafikim me qenie njerëzore në nenin 418-a, gjithashtu përfshijnë edhe dy vepra tē reja penale – *Kontrabandim i emigrantëve* në nenin 418-b dhe *Organizim tē grupeve dhe nxitjen e trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandim tē emigrantëve* në nenin 418-v.

Korniza juridike penale u përforcua në vitin 2005 me miratimin e *Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve* me çka legjislacioni vendas u harmonizua me dispozitat e protokolit të dytë plotësues tē Komisionit European për ndihmë tē përbashkët në çështjet penale²³.

Në vitin 2007 Ministria e drejtësisë zbatoi analiza mbi kompatibilitetin e legjislacionit kombëtar me dispozitat e Konventës tē Këshillit të Europës për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe përpiloji raport me rekondime për të gjitha intervenimet juridike dhe legjislative të cilat duhet të ndërmerren para ratifikimit të Konventës²⁴. Kodi penal dhe Ligji për procedurën penale u ndryshuan në drejtim të plotësimit dhe përmirësimit të masave ekzistuese për identifikim dhe mbrojtjen e fëmijëve viktima (potenciale) në trafikimin me qenie njerëzore.

Në vitin 2008, Ligji i ri për tē huajt është paraqitur si *politikë mbrojtëse për parandalimin nga migrimi ilegal dhe trafikimi me fëmijë* përmes urdhëresës për masa/kërkesa më të rrepta për hyrjen e personave të mitur pa përcjellje në territorin e Republikës së Maqedonisë. Ligji i Ri për tē huajt, gjithashtu, mundëson periudhë për vendimmarrje në kohëzgjatje deri në dy muaj për viktimat e huaja i cili ju mundëson viktimave më shumë kohë për të pranuar ndihmë dhe tē vendosin se a do të dëshmojnë kundër trafikantëve me qenie njerëzore. Pas periudhës për vendimmarrje, viktimës i lëshohet leje për qëndrim të përkohshëm në kohëzgjatje prej gjashtë muajve me mundësi vazhdimi nëse procesi gjyqësor vazhdon. Konventa e Këshillit të Europës për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore u ratifikua me 14 prill tē vitit 2009²⁵.

Me ndryshimet në KP tē Republikës së Maqedonisë në janar tē vitit 2008 është përfshirë vepër e re penale *Trafikimi me persona të mitur* me nenin 418-g me çka

²³ Konventa e Këshillit të Europës përpiluar në Strazbur, 8 XI 2001, një sërë marrëveshjesh nr. 182.

²⁴ Tanja Kikerekova, analizë para-ratifikuese e Konventës së Këshillit të Europës mbi aktivitetet kundër trafikimit me qenie njerëzore, 2007.

²⁵ Gazeta zyrtare 49/2009.

është vënë një theks i veçantë në mbrojtjen e viktimave të mitur në trafikimin me qenie njerëzore dhe ndjekjen e autorëve ku dënim i paraparë minimal për këtë vepër penale është tetë vjet. Nenet e reja e kriminalizojnë dhe i përcaktojnë format themelore të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandimin e emigrantëve, format e krimit të cilat mund të shkaktojnë pasoja më serioze dhe më të rënda, si edhe dënim i përveprat organizim dhe nxitje si të tillë.

Nëse bëhet një pasqyrim i reformave legjislativës në vitin 2009, do të vërehet se në Ligjin përfshirë familjen përfshirë herë të parë në Republikën e Maqedonisë parashtronet çështja përfshirë mbrojtjen e fëmijëve viktima të trafikimit me qenie njerëzore dhe në të shtohet kapitull i ri V-a – “Kujdestaria mbi personat e mitur viktima të trafikimit me qenie njerëzore” me gjashtëmbëdhjetë nene të reja.

Në shtator në vitit 2009 u miratuan ndryshimet e Kodit penal, të neneve 418-a,b dhe g. Sanksionohet përgjegjësia e personave zyrtarë gjatë kryerjes së veprave të lidhura me trafikimin qenieve njerëzore, edhe atë më së paku tetë, gjegjësisht dhjetë vjet burg nëse viktima është e mitur.

Përforcimi i mbrojtjes së personave viktimë të trafikimit me qenie njerëzore me kornizën ligjore në qershor të vitit 2009 vazhdon me miratimin e Ligjit përfshirë mbrojtje sociale, në të cilin është përfshirë dispozita (n.31) me të cilën mbrohen personat viktima të trafikimit me qenie njerëzore.

Në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit përfshirë mbrojtjen e fëmijëve në vitin 2009, në nenin 9, ndalojen të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe keqpërdorimit seksual të fëmijëve (pornografia fëmijërore, prostitucioni fëmijëror), nxitja e dhunshme, shitja ose trafikimi me fëmijë, dhunë psiqike ose fizike dhe maltretim, dënim ose tjetër veprim jonjerëzor, të gjitha llojet e eksplorimit, shfrytëzimi komersial dhe keqpërdorimi i fëmijëve, me të cilat shkelen liritë dhe të drejtat themelore njerëzore dhe të drejtat e fëmijëve.

Në përputhshmëri me detyrimet të cilat dalin nga Ligji përfshirë mbrojtje sociale, neni 26 dhe neni 31, mbrojtjen e personave viktima të trafikimit me qenie njerëzore e mundëson Qendra përfshirë personat viktima të trafikimit (neni 132). Me 28.01.2011 është hapur strehimorja shtetërore përfshirë mbrojtjen e personave viktima të trafikimit me qenie njerëzore, gjegjësisht Qendra përfshirë personat viktima të trafikimit me qenie njerëzore. Përfshirë funksionim të kësaj Qendre, sipas standardeve ndërkombëtare përfshirë të drejtat e njeriut, janë përpiluar dokumenta interne të cilat kanë të bëjnë me procedurat e referimit, strehimit, qëndrimit, të rregullave përfshirë sjellje të personelit të angazhuar, të protokolit përfshirë mbrojtje dhe të gjashme.

Zhvillimi i kornizës ligjore përfshirë mbrojtjen e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore vërehet edhe në revidimin e përmbytje së PSO përfshirë ndihmë të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vitin 2010.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë plotësisht i përmbush standardet minimale për eliminim të trafikimit me qenie njerëzore. Qeveria bëri hapa të rëndësishëm në përpjekjet e veta për zbatimin e ligjit për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore, duke ndjekur penalisht numër të madh të autorëve si edhe duke dorrëzuar padi dhe duke dënuar persona për bashkëveprim në trafikimin me qenie njerëzore në vitin 2011²⁶

- **Orientimet strategjike që kanë të bëjnë me përmirësimin e kornizës juridike dhe ndjekjes penale në pajtueshmëri me Aksion planin Kombëtar të vitit 2013-2016**

Korniza e tanishme juridike ofron bazë të gjërë për mbrojtjen e viktimate, procedurës para hetimore, hetim dhe procedurë penale për veprat penale lidhur me trafikimin me qenie njerëzore. Qeveria edhe më tej do ta avancojë mbrojtjen e viktimate në periudhën e ardhshme përmes avancimit të bazës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të viktimate me sigurimin *pa pagesë* të: *mbrojtjes shëndetësore dhe ndihmës juridike për secilën viktimë*. Janë planifikuar ndryshime dhe plotësime të Ligjit për mbrojtje sociale neni 145 me qëllim të vazhdimit të afatit për strehim të viktimate të trafikimit me qenie njerëzore në Qendrat për personat viktima të trafikimit me qenie njerëzore. Realizimi i mekanizmave për kompensim do të jetë i suksesshëm me Miratimin e Ligjit për *fondin shtetëror për kompensimin e viktimate*.

Korniza juridike penale për trafikimin e qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal ishte e përmirësuar, por, edhe në të ardhmen do të punohet mbi avancimin e saj.

Me Ligjin e ri për procedurën penale institucionet kompetente për hetim dhe ndjekje penale (MPB dhe PP) do të mundësojë procedurë efikase para hetimore me sigurimin e dëshmive kualitative për zbatimin e sukseshëm të procedurave penale kundër autorëve, me aktvendim gjyqësor.

Të drejtat e viktimate, do të avanchohen me qasje deri tek ndihma pa pagesë juridike, emërimin e përfaqësuesve juridik në rast se viktima është e mitur, por, gjithashtu edhe me zhvillimin e aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimeve për gjykatesit dhe prokurorët.

Qeveria, përpinqet drejt *përforcimeve* të mëtutjeshme të bashkëpunimit dhe koordinimit rajonal dhe ndërkombëtar mu për shkak se strategjia efikase në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore bazohet në bashkëpunimin e fuqishëm operativ dhe strategjik ndërkombëtar me vendet e treta.

Përpjekjet e procedurës hetimore dhe ndjekja penale do të përforcohen në nivel rajonal përmes implementimit të plotë të Konventës së Vienës (2006) për bashkëpunim policor në Europën Juglindore.

Bashkëpunimi ndërkombëtar juridik do të jetë në vazhdimësi e promovuar përmes vizitave studimore, trajnimeve dhe seminareve.

²⁶ Raporti i Departamentit Shtetëror për trafikim me qenie njerëzore për vitin 2011, Maqedonia në TIER1

III. SFERAT STRATEGJIKE

1 – KORNIZA (KUADRI) MBËSHTETËSE

Qëllimi strategjik 1. Strukturat koordinuese

Qëllimet specifike:

- a) Fuqizimi i rolit koordinativ të Komisionit Kombëtar dhe transparenca e përmirësuar në implementimin e aktiviteteve;
- b) Fuqizimi i rolit të Komisionit Kombëtar në nivel lokal;
- c) Përmirëimi i koordinimit dhe badhkëpunimit midis institucioneve në ivel qendror dhe lokal për identifikim, ndihmë dhe mbështetjen e viktimateve potenciale dhe grupeve të rrezikut;

Rezultatet e pritura:

- a) Pjesëmarrje e siguruar e rregullt dhe aktive e anëtarëve të Komisionit Kombëtar dhe organeve të saj të punës;
- b) Qarkullim i përmirësuar i informatave prej anëtarëve të Komisionit Kombëtar deri te institucionet/ organizatat amë;
- c) Informimi i shtuar i anëtarëve të Sekretariatit për aktivitetet e institucioneve/ organizatave të tyre;
- d) Janë formuar komisione lokale për trafikimin me qeniet njerëzore dhe janë zbatuar aktivitete në pajtim me APK në nivel lokal;
- e) Kapacitete të fuqizuara në nivel lokal dhe koordinim midis institucioneve përfshirë këtu edhe sektorin qytetare.

Palët e interesuara dhe partnerët: Koordinatori Kombëtar, Raportuesi Kombëtar, Komisioni Kombëtar dhe sekretariati, ministritë përkatëse, institucione dhe shoqata të qytetarëve, institucione qeveritare në nivel lokal, Njësitë e vetëqeverisjes lokale, Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e punëve të brendshme.

Implikime financiare: Ministria e punëve të brendshme dhe Ministria e punës dhe politikës sociale.



Qëllimi strategjik 2. Korniza ligjore dhe rregulluese

Qëllimet specifike:

- a) Harmonizimi i kornizës ligjore kombëtare me kornizën ligjore ndërkontrolluese;
- b) Avancimi i legjislacionit kombëtar në drejtësi të mbrojtjes së të drejtave të viktimave;
- c) Themelimi i fondit për dëmshpérblimin e viktimave, në pajtim me vendimet e parashikuara në Ligjin e ri për oricedurën penale;
- d) Themelimi i mekanizmave për identifikimin dhe procedurën me viktimat potenciale të trafikimit me qeniet njerëzore midis emigrantëve ilegal;

Rezultatet e pritura:

- a) Korniza ligjore kombëtare e harmonizuar me kornizën ligjore ndërkontrolluese;
- b) Baza ligjore përmes mbojtjen e të drejateve të viktimave e avancuar;
- c) Është siguruar baza ligjore për themelin e fondit shtetëror për dëmshpérblimin e viktimave;
- d) Janë identifikuar viktimat potenciale të trafikimit me qeniet njerëzore midis emigrantëve ilegal

Palët e interesuara dhe partnerët: Ministria e drejtësisë, Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e punëve të jashtme dhe SÇE.

Implikime financiare: Ministria e punëve të brendshme.

Qëllimi strategjik 3. Bashkëpunimi ndërkontrollues

Qëllimi specifik: Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkontrollues dhe koordinimi midis institucioneve relevante në sferën e trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimit ilegal.

Rezultatet e pritura:

- a) Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkontrollues në sferën e trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimit ilegal;
- b) Fuqizimi i bashkëpunimit me shtetet e EJL dhe UE

Palët e interesuara dhe partnerët: Ministria e punëve të brendshme, Ministria e drejtësisë, Ministria e punës dhe politikës sociale, Gjyqësia, Prokuroria Publike dhe Shoqatat e qytetarëve.

Implikime financiare: Ministria e punëve të brendshme, Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e drejtësisë, Prokuroria Publike, Gjyqësia, Shoqatat e qytetarëve dhe donacione.



Qëllimi strategjik 4. Menaxhimi me informatat, monotorimi dhe vlerësimi

Qëllimi specifik: Avancimi i sistemit të menaxhimit me informatat, monotorimi dhe vlerësimi.

Rezultatet e pritura:

- a) Deri në fund të vitit 2016 të themelohet bazë e centralizuar e të dhënave për viktimat dhe keqbërësit;
- b) Kapacitete të përforcuara të Raportuesit Kombëtar;
- c) Sistem i vendosur për informim dhe evidentim

Palët e interesuara dhe partnerët: Komisioni Kombëtar, Zyra e Koordinatorit Kombëtar и Raportuesi Kombëtar

Implikime financiare: Komisioni Kombëtar, Ministria e punëve të brendshme, dhe IPA-fondet dhe donacionet.

2 - PARANDALIMI (PREVENIMI)

Qëllimi strategjik 1. Identifikimi i arsyeve për paraqitjen e trafikimit të qenieve njerëzore/ fëmijë dhe emigrimit ilegal

Qëllimi specifik: Konfirmimi i rreziqeve dhe grupeve të rrezikut për paraqitjen e trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal në Republikën e Maqedonisë.

Rezultatet e pritura:

- a) Identifikimi i rreziqeve dhe grupeve të rrezikut për trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrimin ilegal

Palët e interesuara dhe partnerët: Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e arsimit dhe shkencës /Biro për zhvillimin e arsimit и Shoqatat e qytetarëve

Implikime financiare: Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e arsimit dhe shkencës/ Biro për zhvillimin e arsimit, Shoqatat e qytetarëve dhe donacione.

Qëllimi strategjik 2. Fuqizimi i kapaciteteve për realizimin e aktiviteteve parandaluese

Qëllimet specifike:

- a) Përforcimi i kapaciteteve në kuadrin arsimor – edukativ dhe shërbimet profesionale në shkollat fillore dhe të mesme dhe në Institucionet publike për mbrojtjen sociale dhe Shoqatat e qytetarëve për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

- b) Përforcimi i kapaciteteve me qëllim të pengimit të eksploatimit të punës në institucionet dhe Shoqatat e qytetarëve.
- c) Rritja e përgjegjësisë gjatë informimit të përfaqësuesve të mediave për trafikimin e qenieve njerëzore/ fëmijët.
- d) Përforcimi i kapaciteteve të punëtorëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve për trafikimin e qenieve njerëzore.
- e) Rritja e informimit të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme për trafikimin e qenieve njerëzore.
- f) Përforcimi i kapaciteteve të përfaqësive diplomatike – konzullare të Republikës së Maqedonisë.

Rezultatet e pritura:

- a) Përforcohen kapacitetet në institucionet arsimore – edukative dhe Institucionet publike për mbrojtjen sociale dhe Shoqatat e qytetarëve për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore.
- b) Përforcohen kapacitetet e të gjitha institucioneve dhe Shoqatave të qytetarëve për parandalimin e eksploatimit të punës.
- c) Vetëdije e ngritur për mënyrën e informimit për trafikimin e qenieve njerëzore/ fëmijëvë.
- d) Informimi i rritur i punëtorëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve për trafikimin e qenieve njerëzore.
- e) Rritet informimi i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme për trafikimin e qenieve njerëzore.
- f) Informimi i rritur i të punësuarve në përfaqësítë diplomatike – konzullare.

Palët e interesuara dhe partnerët: Ministria e punëve të brendshme, Ministria e punëve të jashtme, Ministria e shëndetësisë, Ministria e punës dhe politikës sociale/ Inspektorati shtetëror i punës, Ministria e arsimit dhe shkencës/Biro për zhvillimin e arsimit, Komisioni Kombëtar, media, Shoqata e gazetarëve, Shoqatat e qytetarëve dhe Sindikatet.

Implikime financiare: Ministria e arsimit dhe shkencës/Biro për zhvillimin e arsimit, Ministria e shëndetësisë, Ministria e punëve të jashtme, Ministria e punës dhe politikës sociale/ Inspektorati shtetëror i punës, Komisioni Kombëtar, Sindikatet, Shoqatat e qytetarëve dhe donacione.

Qëllimi strategjik 3.Ngritja e vetëdijes publike dhe edukimi

Qëllimet specifike:

- a) Ngritja e vetëdijes publike për trafikimin e qenieve njerëzore/ fëmijët dhe emigrimin ilegal;
- b) Rritja e vetëdijes te grupet e ndjeshme për problemin e trafikimin e qenieve njerëzore.

Rezultatet e pritura:

- a) Informimi dhe vetëdija e rritur te popullata e përgjithshme për problemin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimin ilegal.
- b) Rritet vetëdija te grupet e ndjeshme për trafikimin e qenieve njerëzore.

Palët e interesuara dhe partnerët: Komisioni Kombëtar, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e arsimit dhe shkencës/Biro për zhvillimin e arsimit, Sekretariati dhe Shoqata e gazetarëve

Implikime financiare: Ministria e punëve të brendshme / Komisioni Kombëtar, Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e arsimit dhe shkencës/Biro për zhvillimin e arsimit, Shoqatat e qytetarëve dhe donacione

Qëllimi strategjik 4. Reduktimi i ndjeshmërisë

Qëllimi specifik: Avancimi i mekanizmave pwr reduktimin e arsyeve pwr paraqitjen e trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigrimin ilegal.

Rezultatet e pritura:

- a) Përbajtje të realizuara për trafikimin e qenieve njerëzore dhe emigrimit ilegal në programet mësimore në arsimimin superior.
- b) Grupe të ndjeshme ekonomikisht të fuqizuara.

Palët e interesuara dhe partnerët: Ministria e arsimit dhe shkencës, UQM, Ministria e punës dhe politikës sociale, Agjencia për punësim, Shoqata e punëdhënësve, vetëqeverisja lokale Vetëqeverisja lokale i Shoqatat e qytetarëve.

Implikime financiare: Ministria e arsimit dhe shkencës, UQM, Ministria e punës dhe politikës sociale, Njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe donacione.

3 – MBËSHTETJA DHE MBROJTJA E VIKTIMAVE DHE EMIGRANTËVE

Qëllimi strategjik 1. Identifikimi dhe udhëzimi i viktimateve

Qëllimi specifik: Përmirësimi i procedit të identifikimit dhe udhëzimit të viktimateve të trafikimit të qenieve njerëzore.

Rezultatet e pritura:

- a) Efikasitet i shtuar në identifikimin, udhëzimin dhe mbrojtje;
- b) Zgjidhen Shoqatat e qytetarëve për mbrojtjen e viktimateve të trafikimit të qenieve njerëzore në pajtim me kriteret për zgjedhje.

Palët e interesuara dhe partnerët: Ministria e punëve të brendshme–NJTQNKE, Komisioni Kombëtar, Ministria e punës dhe politikës sociale–MKU dhe Shoqatat e qytetarëve.

Implikime financiare: Ministria e punëve të brendshme, Ministria e punës dhe politikës sociale, Komisioni Kombëtar, Shoqatat e qytetarëve dhe donacione.

Qëllimi strategjik 2. Mdihami dhe mbrojtja direkte e viktimateve dhe emigrantëve

Qëllimet specifike:

- a) Sigurimi i mbrojtjes së viktimateve dhe emigrantëve ilegal në pajtim me standarde ndërkontaktare;
- b) Integrimi i viktimateve të trafikimit të qenieve njerëzore në mjediset sociale;
- c) Sigurimi i mjetave për rikthimin në atdhe të emigrantëve ilegal.

Rezultatet e pritura:

- a) Vend i sigurt për vendosjen, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimateve të trafikimit të qenieve njerëzore.
- b) Kapacitete të ngritura të kuadrove profesional dy vendeve të pranimit: Qendrës për personat viktima të trafikimit të qenieve njerëzore dhe Qendrës së pranimit të personave të huaj;
- c) Viktimat dhe emigrantët ilegal janë informuar për të drejtat dhe obligimet e tyre;
- d) Janë përpiluar dhe në vazhdimësi po realizohen programet për ndihmë, mbështetje dhe reintegrim të viktimateve të trafikimit të qenieve njerëzore.
- e) Janë zgjedhur Shoqatat e qytetarëve për mbrojtjen e viktimateve të trafikimit të qenieve njerëzore në pajtim me kriterete për zgjedhje.
- f) Janë siguruar mjetë për rikthimin në atdhe të emigrantëve ilegal dhe viktimateve të trafikimit të qenieve njerëzore.

Palët e interesuara dhe partnerët: Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e drejtësisë, Ministria e arsimit dhe shkencës, Ministria e shëndetësisë, Shoqatat e qytetarëve, Vetëqeverisja lokale dhe organizatat ndërkombëtare.

Implikime financiare: Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e shëndetësisë, Ministria e drejtësisë, Ministria e arsimit dhe shkencës, Shoqatat e qytetarëve, Vetëqeverisja lokale dhe donacione.

4 – PROCEDURA PARA-HETIMORE DHE PENALE PËR TRAFIKIMIN ME QENIET NJERËZORE DHE KONTRABANDIMIN E EMIGRANTËVE

Qëllimi strategjik 1. Procedura para-hetimore (investigimet proaktive dhe reaktive)

Qëllimet specifike:

- Përforcimi i kapaciteteve të Ministrisë së punëve të brendshme në drejtim të zbulimit të keqbërësve të veprave kriminale të trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigimit ilegal;
- Avancimi i baskëpunimit ndër-institucional lidhur me këmbimin e informatave dhe zbatimin e koordinuar të investigimeve gjatë trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigimit ilegal;
- Përmirësimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar në pjesën e zbatimit të investigimeve.

Rezultatet e pritura:

- Nëpunës policor të trajnuar;
- Hetime (investigime) të realizuara me sukses;
- Bashkëpunim i përforcuar ndër-institucional gjatë zbatimit të investigimeve;
- Investigime ndërkombëtare të realizuara me sukses.

Palët e interesuara dhe partnerët: Ministria e punëve të brendshme, Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e financave dhe Prokuroria Publike.

Implikime financiare: Ministria e punëve të brendshme, Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e financave dhe Prokuroria Publike.



Qëllimi strategjik 2. Procedura penale

Qëllimet specifike:

- a) Përmirësimi i cilësisë së procedurave penale;
- b) Realizimi i të drejtave të viktimës në procedurën penale me shqyrtim të veçantë në të drejtat e fëmijëve.

Rezultatet e pritura:

- a) Kapacitetet e fuqizuara të gjykatësve dhe prokurorëve;
- b) Të drejtat e viktimave/ fëmijëve në procedurën penale janë siguruar.

Palët e interesuara dhe partnerët: Akademia për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve publik, Ministria e drejtësisë, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e punës dhe politikës sociale, Prokuroria Publike, Gjykata dhe Shoqatat e qytetarëve

Implikime financiare: Akademia për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve publik, Ministria e drejtësisë, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e punës dhe politikës sociale, Prokuroria Publike, Gjykata dhe Shoqatat e qytetarëve, Të akuzuarit ose buxheti i RM.

SHTOJCA I – REFERENCAT

A. Instrumentet juridike kombëtare për luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore

1. Kodi penal I RM, Gazeta Zyrta e RM nr. 37/96, me ligjet dhe ndryshimet dhe amandamentet e Kodit penal, Gazeta Zyrta e RM nr. 88/99, 4/2002, 43/2003, 9/2004 dhe 139/08, Gazeta Zyrta e RM nr. 49/2009, Gazeta Zyrta e RM nr. 51/2011
2. Ndryshimet e Ligjit për procedure penale, Gazeta Zyrta e RM nr. 74 prej 22 tetor, 2004 dhe Gazeta Zyrta e RM nr. 83 prej 10.07.2008, Gazeta Zyrta e RM nr. 150 prej 18.11.2010
3. Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, Gazeta Zyrta e RM nr. 38/05 miratuar në 26.5.2005 me Ligjin për ndryshimet dhe amandamentet e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, Gazeta Zyrta e RM nr. 58/5 od 19.7.2005, dhe implementimi i filluar në 1.1. 2006;
4. Ligji për të huaj, Gazeta Zyrta e RM nr. 35 prej 23.03.2006; ka hyrë në fuqi në 23.03.2007;
5. Ligji për punësimin e të huajve, Gazeta Zyrta e RM nr. 70/2007; dhe Ligji për ndryshimet dhe amandamentet e Ligjit për punësimin e të huajve, Gazeta Zyrta e RM nr. 5 prej 13.1.2009;
6. Protokolli për parandalimin, shpartallimin dhe ndëshkimin e trafikimit me qeniet njerëzore, në veçanti gratë dhe fëmijët, plotësimi i konventës të Kombave të Bashkuara kundër Krimtit të organizuar ndërkombëtar, A.P. Rez. 25, shtojca II, KB GAOR, sesioni nr. 55, shtesat nr. 49, të Dok. të KB nr. 60 A/45/49 (Botimi I) (2001), k HYRË Në FUQI Në 9 SHTATOR 2003 (nënshkruar 2000 dhe ratifikuar nga Qeveria e Maqedonisë në vitin 2004).
7. Ligji për ratifikimin e Konventës për ngrirjen e mjeteve dhe konfiskimin e të ardhurave orej krimtit të vitit 2006, Gazeta Zyrta e RM nr. 55/2007;
8. Ligji për ratifikimin dhe bashkëpunimin e policisë të Evropës Juglindore, 22 qershor 2007, Gazeta Zyrta e RM nr. 74/2007;
9. Ligji për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për luftën kundër trafikimit me qeniet njerëzore të vitit 2005, 14 prill 2009, Gazeta Zyrta e RM nr. 49/2009.
10. Urdhëri i ministrit të punëve të brendshme për procedurën me të huajt që janë viktima të trafikimit me qeniet njerëzore – Ministria e punëve të brendshme, mars 2006 (ishte në fuqi deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për të huaj në 23.3. 2007);

11. Urdhëri i Ministrisë së punëve të brendshme për çështjen e miratimit të vizave për të huaj, prolongimin e vlefshmërisë së vizës dhe térheqjen e vizës, 1.10. 2007.
12. Urdhëri i Ministrisë së punëve të brendshme për udhëtim edhe dokumentet e tjera për të huaj, 2.4.2008;
13. Urdhëri i Ministrisë së punëve të brendshme për rregullat e shtëpisë në Qendrën përkujdes, 1.10. 2008;
14. Procedurat operative standarde – POS për ndihmë të viktimate të trafikimit me qeniet njerëzore, 2010, Komisioni Kombëtar për luftë kundër trafikimit me qeniet njerëzore dhe emigrantët ilegal, Ministria e punëve të brendshme;
